



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Ac.nr.1148/2018

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj kryetar dhe Lumni Sallauka e Arsim Hamzaj anatarë, në çështjen kontestimore të paditësve M. A, E. A dhe N. Xh që të tre nga ..., Komuna e Ferizajt të cilët me autorizim i përfaqëson A. I avokat nga Prishtina, kundër të paditurës "S..." me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim K. P, në çështjen juridike kompensim i dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditësve dhe ankesës së të paditurës, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.395/15 të datës 23.06.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.06.2024 mori këtë:

### A K T G J Y K I M

REFUZOHEN si të pa bazuara, ankesa e paditësve M. A, E. A dhe N. Xh, që të gjithë nga ..., Komuna e Ferizajt dhe ankesa e të paditurës "S..." Sha. me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.395/15 i datës 23.06.2017, VËRTETOHET.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit ka miratuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve M. A, E. A dhe N. Xh , si të bazuar dhe në pikën II., të dispozitivit është detyruar e paditura "S..." që paditësve në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material t'u paguajë shumat dhe atë: paditësit M. A, në emër të dëmit jo material, për dhimbjet trupore – fizike, shumën prej 1,200.00 €, për frikën e pësuar shumën prej 950.00 €, në emër të dëmit material, për shpenzimet e mjekimit shumën prej 809.00€. Paditësit E. A, në emër te dëmit jo material, për dhimbjet trupore shumën prej 1,400.00 €, për frikën e pësuar shumën prej 1,050.00€, në emër të dëmit material, për shpenzimet e mjekimit shumën prej 668.00€. Paditësit N. Xh, për dhimbje trupore shumën prej 1,300.00€, për frikën e pësuar shumën prej 1,000.00€, në emër te dëmit material, për shpenzimet e mjekimit shumën prej 374.00€. Në pikën III., të dispozitivit të aktgjykimit është

refuzuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve mbi lartësitë e shumave të aprovuara në pikën II., të dispozitivit dhe atë: paditësit M. A, për dhimbje trupore shumë prej 1,300.00 €, për frikën e pësuar shumë prej 1050.00€, për ndihmë nga personi tjetër shumë prej 30.00 €, për ushqim të përforcuar shumë prej 50.00€. Paditësit E. A, për dhimbje trupore shumë prej 1600.00€, për frikën e pësuar shumë prej 950.00€, për ndihmë nga personi tjetër shumë prej 50.00€, për ushqim të përforcuar shumë prej 50.00€. Paditësit N. Xh, për dhimbje trupore shumë prej 1700.00€, për frikën e pësuar shumë prej 1000.00€, për ndihmë nga personi tjetër shumë prej 30.00€, për ushqim të përforcuar shumë prej 30.00€. Në IV., të dispozitivit është detyruar e paditura që paditësve t'ia paguaj shumat e cekura në pikën III., të dispozitivit në shumë të përgjithshme prej 8,751.00 €, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% nga data 15.07.2015 e deri ne pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1618.00, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas marrjes së formës së prerë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi paditësit M. A, E. A dhe N. Xh, që të gjithë nga ..., Komuna e Ferizajt nëpërmjet të autorizuarit të tyre A. I kanë parashtruar ankesë për shkak të zbatimit të gabuar të të drejtës materiale. Pala paditëse ka propozuar që gjykata e shkallës së dytë ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë, dhe ta miratoj në tërësi kërkesëpadinë e precizuar si në parashtrësën për precizim të datës 07.06.2017.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, pas shqyrtimit të ankesës aktgjykimin ankimor të shkallës së parë ta prishë dhe ta kthej lëndën në rigjykim.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesat e parashtruara janë të pa bazuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit M. A, E. A dhe N. Xh kanë paraqitur padi më datë 15.07.2015, në Gjykatën Themelore në Ferizaj, për kompensim dëmi material dhe jo material, ndaj të paditurës "S..." Sha. me seli në Prishtinë dhe me precizimin e bërë me datë 07.06.2017 ka kërkuar nga kjo Gjykatë, që kjo kërkesëpadi ti aprovohet dhe të detyrohet e paditura që paditëses në emër të kompensimit t'ia paguaj shumë prej 16,500.00 €, dhe atë paditësit M. A, për dëmin jo material, për dhimbjet fizike shumë prej 2,500.00 €, për frikën shumë prej 2,000.00 €, për dëmin material, për

ndihmën dhe përkujdesin e huaj shumën prej 30.00 €, për ushqim të përforcuar shumën prej 50.00 €, për shpenzimet materiale gjatë kohës së shërimit shumën prej 809.00 €, gjithsejtë në shumën prej 5.389.00. Padiësit E. At, për dëmin jo material, për dhimbjet fizike shumën prej 3,000.00€, për frikën shumën prej 2,000.00 €, për dëmin material, për ndihmën dhe përkujdesjen e huaj shumën prej 50.00 €, për ushqim të përforcuar shumën prej 50.00 €, për shpenzimet materiale gjatë kohës së shërimit shumën prej 668.00 €, gjithsej 5,768.00 €. Padiësit N. Xh, për dëmin material, për dhimbjet fizike shumën prej 3,000.00 €, për frikën shumën prej 2,000.00 €, për dëmin material, për ndihmën dhe përkujdesjen e huaj shumën prej 30.00 €, për ushqim të përforcuar shumën prej 30.00 €, për shpenzimet materiale gjatë kohës së shërimit shumën prej 374.00 €, gjithsej 5,434.00 €, të gjitha në kamatë vjetore në lartësinë prej 8 % duke filluar nga data e gjykimit e deri në pagesën përfundimtare. Po ashtu kane kërkuar t'ia paguajë shpenzimet gjyqësore dhe atë: për përpilimin e padisë 208.00 €, për taksat gjyqësore për padi 75.00 € , dhe për taksat gjyqësore për aktgjykim 75.00€, për shpenzimet e ekspertizës mjekësore 500.00 €, për çdo shqyrtim me praninë e të autorizuarit të padiësve nga 540.00 € (sipas tarifës së OAK pasi që kemi të bëjmë me përfaqësimin e tri (3) palëve në procedurë dhe vlera e kontestit është mbi 10.000.00 €, gjithsejtë tre (3) shqyrtime x 540.00 € = 1,620.00 €, gjithsejtë për shpenzime gjyqësore, shumën prej 2,478.00 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat dhe atë, padia e padiësve C.nr.395/15 e datës 15.07.2015, raporti i policisë hetuese 2015 –CFT-181 e datës 20.05.2015 së bashku me skicën përcjellëse raporti I emergjencës për padiësin M. A e datës 20.05.2015 nr. protokollit 168, raporti i emergjencës për padiësin N. Xh i datës 20.05.2015 nr. Protokollit 171, autorizimi i padiësve dhënë avokat Z. I, përgjigja në padi e të paditurës e datës 20.09.2016, autorizimi i padiësve dhënë avokat A. I, kërkesa e padiësve drejtuar të paditurës në procedurë administrative e datës 15.07.2015, raporti i emergjencës lëshuar për padiësin E. A me nr. Protokollit 9099/2013 e datës 23.07.2015, libri i protokollit të regjistrimit të pacientëve ku shihet se me nr. rendor 1550 është emri i padiësit E. A, procesverbali i datës 17.05.2017 ne të cilën është nxjerr prova përmes ekspertëve për padiësit M. A dhe N. Xh, procesverbali i datës 31.05.2017 kur është nxjerr prova përmes ekspertëve mjekësor për padiësit E. A, specifikacioni i shpenzimeve për padiësin M. A e datës 18.05.2017, specifikacioni i shpenzimeve për padiësin N. Xh i datës 18.05.2017, specifikacioni i shpenzimeve për padiësin E. A e datës 18.05.2017, autorizimi i të paditurës dhënë perf. Kujtim Pula, parashtresa për precizimin e padisë e datës 07.06.2017, raportet mjekësore për padiësin .

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave, ka vërtetuar këtë gjendje faktike se, ndërmyjet palëve ndërgjyqës nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadiës, por vetëm lartësia

e saj. Nga administrimi i provave raporti i aksidentit të komunikacionit , është vërtetuar se i siguruari i të paditurës ka qenë fajtor, i cili ishte duke e drejtuar automjetin transportues ... , me ngjyrë të ..., me targa të regjistrimit ... dhe që ishte duke lëvizur nga Ferizaj në drejtim të ... dhe me të arritur në rrugë për në ..., Komuna e Ferizajt, hynë në tejkallim të një automjeti dhe duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe kushteve të rrugës, duke vozitur në mënyrë të pakujdesshme, gjatë këtij veprimi të pa sigurt me pjesën e parë të anës së majtë të automjetit të tij e godet automjetin ... në pjesën e prapme e cila ishte duke lëshuar rrugën magjistrale për të hyrë në fshatin ... e pas kësaj goditje njësia dy del nga rruga në anën e majtë, kurse njësia një pas disa metrash ndalet në skajin e rrugës në anën e djathtë. Më rastin e aksidentit të ndodhur me datë 20.05.2015 dhe fakti se e paditura ka detyrim dhe përgjegjësi civile në kuptim të nenit 961 të LMD-së për shpërblimin e dëmit jo material dhe material nga aksidenti i datës 20.05.2015 pasi që shkaktari i aksidentit ka qenë i siguar tek e paditura të cilën nuk e ka kontestuar as e paditura po e ka kontestuar lartësinë e kërkuar nga ana e paditësve. Gjykata e shkallës së parë lidhur me lartësinë e dëmit material dhe jo material ka vendosur sipas vlerësimit të lirë në kuptim të nenit 323 të LPK-së dhe në kuptim të dispozitave të neneve 136, 159, 169, 174, 182, dhe 961 të LMD-së, duke u bazuar në mendimin e ekspertëve mjekësor Dr. B. I ortoped-traumatolog dhe Dr. M. A neuro-psikiatër të cilëve gjykata ia ka falur besimin në tërësi, mendimin e tyre e kanë dhënë në procesverbalin e datës 17.05.2017 dhe në seancën e datës 31.05.2017 si dhe dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës të cilat janë administruar si prova në këtë çështje juridike. Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka bazuar në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së.

Në këtë çështje Gjykata Kushtetuese e Kosovës, me pesë (5) vota për dhe katër (4) kundër, me Aktgjykimin KI121/22 të datës 16.05.2024, kishte shpallë të pavlefshme Aktvendimin e Gjykatës Supreme Rev.nr.434/22 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev.nr.426/2021 dhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit ac.nr.1148/2018 të datës 04.03.2020. në pikën IV. të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese kthyer në rivendosje. Nga aktgjykimi i Gjykatës së Apelit i sulmuar në Gjykatën Kushtetuese, rrjedhë se Gjykata e Apelit me rastin e hartimit të këtij aktgjykimi në dispozitivin e këtij aktgjykimi nuk kishte përfshirë si të trajtuar edhe ankesën e paditësve M. A, E. A dhe N. Xh, që të gjithë nga ..., Komuna e Ferizajt.

Gjykata Kushtetuese ka theksuar ndër të tjera që mos shqyrtimi i ankesës së paditësve, si rrjedhojë edhe i pretendimeve të ngritura nga ana e tyre në Gjykatën e Apelit, ka cenuar të drejtën e tyre për “qasje në gjykatë”, si rrjedhojë edhe të drejtën për mjet efektiv juridik dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave pranë këtyre instancave gjyqësore.

Në këtë çështje është nxjerrë edhe një Mendim Mospajtures i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese Jeton Bytyqi të cilit i është bashkangjitur edhe gjyqtari Enver Peci, të cilët pasi kanë theksuar që qëndron fakti se parashtruesit e kërkesës kanë pasur një pretendim legjitim që ndërlidhet me mos shqyrtimin e ankesës së tyre nga ana e Gjykatës së Apelit, megjithatë këta dy gjyqtarë kanë konsideruar që parashtruesit e kërkesës kanë pasur në dispozicion mjete juridike për të sfiduar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe asgjë nuk i ka ndaluar që t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese (brenda afatit 4 mujor). Këta gjyqtarë në mendimin e tyre mospajtures kanë theksuar që si “*vendim i fundit*”, sipas nenit 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe paragrafin 1 (c) të Rregullit 34 të Rregullores së Punës, kërkesa është paraqitur jashtë afatit katër (4) mujor.

### **Baza ligjore:**

Neni 194 i LPK-së: “Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi , pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji”.

Neni 195.1 i LPK-së: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj: .....d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur”.

Neni 319.1 i LPK-së: “Secila nga palët ndërgjyqës ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”.

Neni 116 par 1 [Efekti Juridik i Vendimeve], i Kushtetutës: “Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës”.

### **Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:**

Lidhur me pretendimet e palës së paditur, Kolegji i Gjykatës së Apelit gjen se, nga gjendja e vërtetuar faktike mund të konstatohet se, pretendimet ankimore të palës së paditur lidhur me atë se aktgjykimi i atakuar është rrjedhojë e vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, janë të pa themelta dhe vlerëson se gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të provave të administruara të ofruara nga palët ndërgjyqës, ka marrë aktgjykimin i cili sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës së Apelit është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete edhe

për faktet vendimtare duke dhënë shpjegimet dhe arsyet adekuate për një vendosje të këtillë, bazuar në dispozitat përkatëse ligjore që i referohen kësaj çështje kontestuese. Në këtë pikë, kolegji gjen se, ndërmjet palëve në procedurë nuk ka qenë konstatuese se dëmi ka ndodhur dhe se ky dëm ka ndodhur nën përgjegjësinë e të sigurvearit të të paditurës. Pra në mënyrë të gjithanshme, është vërtetuar se dëmi ka ndodhur, se dëmi është shkaktuar nën përgjegjësinë juridike civile të të sigurvearit të paditurës.

Lidhur me pretendimet e palës së paditur për ekzistimin e shkeljeve esenciale, Kolegji i Gjykatës së Apelit, vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, e ka konsideruar si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, e as me shkelje të tjera të kësaj natyre, për të cilat gjykata është e detyruar që të kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Lidhur me pretendimet e palës së paditur sa i përket zbatimit të gabuar të drejtës materiale, kolegji ka gjetur se, nuk qëndrojnë pretendimet e palës së paditur se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes ka caktuar shuma të larta të kompensimit në krahasime me dëmin e ndodhur. Kolegji gjen se ndërmjet palëve në procedurë nuk ka qenë kontestuese baza e përgjegjësisë por vetëm lartësia e shumave të kërkuara me kërkesëpadi. Sipas vlerësimit të kolegjit, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gjithanshme ka vërtetuar natyrën dhe shkallën e dëmit të pësuar për paditësit. Gjykata e shkallës së parë këtë e ka provuar me nxjerrjen e ekspertimit mjekësor nga ana e ekspertëve përkatës mjekësor Dr. B. I ortoped - traumatolog dhe Dr. M. A neuro - psikiatër, të cilët edhe kanë dhënë mendimin e tyre lidhur me natyrën e dëmit dhe shkallën e dëmtimit të paditësve në aksidentin e ndodhur më datën 20.05.2015. Këto ekspertime kolegji i ka cilësuar si profesionale dhe u ka falur besimin në tërësi, pasi që ato përmbushin standardet e kërkuara të ekspertimit dhe të provuarit në përgjithësi. Kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë, duke u bazuar në rregullat e përgjithshme për shpërblimin e dëmit konkretisht nenin 136.1 të LMD-së, i cili përcakton që: *“Kush i shkakton dëm tjetrit ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk e provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*. Meqenëse pretendimet ankimore të palës së paditur kanë të bëjnë me shumën e gjukuara për të cilat kjo konsideron se janë në disproporcion me vëllimin e dëmit të shkaktuar, kolegji i Gjykatës së Apelit ka gjetur se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është në përputhje me nenin 174 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili parashikon që: *“Gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkakimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim”*. Nga kjo, Kolegji i Gjykatës së Apelit gjen se, me rastin e të vendosurit lidhur me

kërkesëpadinë e paditësve, gjykata e shkallës së parë ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimin të cilit i shërben kompensimi i caktuar në dispozitivin e aktgjykimit, gjithmonë duke pasur parasysh, që kompensimi të jetë satisfakcion për të dëmtuarit dhe duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasojë e dëmit të shkaktuar dhe sjelljen e gjendjes materiale të paditësve përafërsisht me gjendjen para se dëmi të jetë shkaktuar. Prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit gjykata e shkallës së parë drejtë i ka zbatuar dispozitat materiale kur ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësve duhet të aprovohet në mënyrë të pjesshme.

Lidhur me pretendimet e palës paditëse dhe të gjeturat e Gjykatës Kushtetuese, Kolegji i Gjykatës së Apelit rithekson se, në rastin konkret nuk bëhet fjalë për mohim të qasjes së palës paditëse në drejtësi, por më tepër mund të flitet për një gabim teknik me rastin e hartimit të draftit përfundimtar të aktgjykimit e që ky gabim mund të ketë rrjedhë si pasojë e sistemit të teknologjisë informative, kur ndryshimet që janë bërë përfundimisht në draftin përfundimtar mund të jetë harruar që të ruhen. Kolegji i Gjykatës së Apelit, përkrah në tërësi vlerësimin që gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese Jeton Bytyqi dhe Enver Peci, të cilët kanë dhënë sqarimet e nevojshme lidhur me mundësitë dhe kohën që ka pasur në dispozicion pala paditëse, për kërkimin e kësaj të drejte brenda afatit kohor të përcaktuar me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese – nenin 49 dhe paragrafin 1 (c) të Rregullit 34 të Rregullores së Punës, dhe se kërkesa është paraqitur jashtë afatit katër (4) mujor. Por ky kolegji sqaron dhe shton edhe faktin se pala paditëse, kërkesën e saj ka pasur mundësi ligjore dhe ka qenë dashur që të realizoj në procedurën kontestimore.

Në nenin 162 të Ligjit për procedurën kontestimore – LPK, është parashikuar që:

*“162.1 Po që se gjykata nuk ka vendosur mbi të gjitha kërkesat që është dashur të përfshihen me aktgjykim, ose kur vetëm një pjesë e kërkesës ka mbetur pa u përfshirë me të, pala mundet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur i është dorëzuar aktgjykimi t'i propozojë gjykatës që të bëjëplotësimin e tij.*

*162.2 Po që se pala nuk paraqet propozim për plotësimin e aktgjykimit do të konsiderohet se padia është tërhequr në pjesën që ka mbetur pa u përfshirë me aktgjykimin e dhënë.*

*162.3 Propozimi i vonuar apo i pathemeltë për plotësimin e aktgjykimit, hidhet poshtë përkatësisht refuzohet nga gjykata pa u caktuar seancë gjyqësore”.*

Nga kjo, sipas vlerësimit të kolegjit, rrjedhë se pala paditëse nuk e ka shfrytëzuar të drejtën e saj të përcaktuar me ligj (neni 162 i LPK-së), të drejtën e saj dhe afatin e parashikuar me nein 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese – nenin 49 dhe paragrafin 1 (c) të Rregullit 34 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në praktikën e saj në jo pak vendime ka vënë në pah *parimin e sigurisë juridike*, duke theksuar që *palës jo vetëm se duhet që ti takojë një e drejtë, por ajo këtë duhet që të kërkojë në mënyrën e përcaktuar me ligj*.

Megjithëkëtë, kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u bazuar në nenin 116 par 1 [Efekti Juridik i Vendimeve], i Kushtetutës: “Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës”, dhe pikën IV të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese KI 121/22 të datës 16.05.2024, duke vlerësuar pretendimet e palës paditëse lidhur me lartësitë e shumave të gjykuara ka gjetur se këto pretendime janë të pa bazuara.

Lidhur me mënyrën e caktimit të lartësive (shumave të kërkuara) për shpërblimin e dëmit Kolegji ka dhënë sqarimet si në pjesën e mësipërme të arsytimit të këtij aktgjykimi, kur ka trajtuar pretendimet e palës së paditur. Por, lidhur me pretendimet e palës paditëse se shumat e caktuara janë më të ulëta, në krahasim me dëmin e pësuar, kolegji ka gjetur se lëndimet e pësuar nga paditësit paraqesin lëndime të lehta trupore. Meqenëse në kohën kur ka ndodhur dëmi dhe kur është vendosur para gjykatës së shkallës së parë, por edhe para gjykatës së shkallës së dytë, nga ana e gjyqësorit nuk ka pasur ndonjë dokument i cili ka rregulluar lartësitë për shumat e gjykuara, për kategoritë shpërblyese të dëmit, kjo ka qenë e rregulluar në bazë të praktikës gjyqësore dhe vendimeve të unifikuara cilat kanë marrë vërtetimin nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës.<sup>1</sup> Në praktikën e gjykatave në këtë kohë, tek rastet kur personat kanë qenë me lëndime të lehta trupore, si në rastin e paditësve, lartësitë e shumave të gjykuara për dhembjet fizike të pësuar janë gjykuar nga 1000,00 - 1200.00 €, për frikën nga 900,00- 1000,00 €. Ndërsa sa i përket dëmit material të pësuar, ky dëm domosdo duhet që të jetë i dokumentuar me dokumente përkatëse- fatura për shpenzimet lidhur me shërimin, rehabilitimin klimatik etj.

Nga kjo që u theksua, Kolegji i Gjykatës së Apelit ka miratuar në tërësi vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me lartësitë e shumave e gjykuara për shpërblimin e dëmit, sepse ato kanë qenë në tërësi të përmbajtura në nenin 136, 159 dhe 174 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve – LMD, por edhe në praktikën e të vendosurit në Kosovë, për raste e tilla. Për këto arsye, kolegji ka

---

<sup>1</sup> Në vitin 2023 Gjykata Supreme e Kosovës, ka nxjerrë Udhëzues për caktimin e kritereve orientuese dhe lartësisë së shpërblimit të dëmit jo material.



vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës paditëse se aktgjykimi i atakuar me ankesën e tyre është përfshirë me zbatim të gabuar të drejtës materiale.

Në nenin 319.1 i LPK-së, është parashikuar që *secila nga palët ndërgjyqës ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*. Kolegji gjene se as pala paditëse e as pala e paditur në procedurën e zhvilluar nuk kanë arritur të bëjnë një gjë të tillë, andaj edhe ankesat e palës paditëse dhe palës së paditur të parashtruara për këtë çështje, janë vlerësuar si të pa themelta dhe për këtë gjë edhe janë refuzuar si e pa bazuara.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.1148/2018 më datë 27.06.2024

Kryetari i kolegjit - gjykatësi

Dr.sc. Rafet Haxhaj